



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT

DOKUMENTI I RREGULLORES
PËR MIRATIMIN E LEJES SË NDËRTIMIT PËR PROJEKTIN:
"QENDRA E TRAJNIMIT PËR ARSIMIN PROFESIONAL", KAMËZ, TIRANË

MIRATOHET
KRYETARI I KKT

Z. EDI RAMA

ZËVENDËS KRYETARE E KKT

Znj. EGLANTINA GJERMENTI
Ministër i Zhvillimit Urban dhe Turizmit

Znj. LINDITA NIKOLLA

Ministër i Arsimit dhe Sportit

Miratur me Vendim të Këshillit Kombëtar të Territorit Nr. 1, Datë 29.12.2014



TABELA E PËRMBAJTJES SË DOKUMENTIT TË RREGULLORES

1.	Dispozita të Përgjithshme
1.1	Baza Ligjore
1.2	Përshkrim i Zonës së Studiuar
1.3	Përkufizimi i Termave të Përdorur
2.	Ekstrakte të Instrumentit të Përgjithshëm Vendor (nëse zona ku parashikohet zhvillimi ka një IPV të miratuar në KKT)
2.1	Orientimet dhe Detyrimet që rrjedhin nga IPV
2.2	Rregullat, Normat dhe Standartet e zhvillimit
2.3	Seti i Fragmenteve të Hartave të IPV për zonën në zhvillim
3.	Analiza e Gjendjes Ekzistuese (elementët ekzistues të territorit)
3.1	Informacion për Topografinë e Zonës
3.2	Informacion për Burimet Natyrore dhe Mjediset Pyjore (nëse IPV ka parashikuar zona të tilla)
3.3	Informacion mbi Zona të Mbrojtura Natyrore dhe ato të Trashëgimisë Kulturore dhe Historike
3.4	Informacion mbi Infrastrukturën Ekzistuese të Zonës për Zhvillim dhe Zonave Përreth saj
3.5	Përmbledhje dhe gjetjet kryesore të Analizës të Gjendjes Ekzistuese
4.	Rregullat e Zhvillimit të Territorit
4.1	Funksionet dhe Aktivitetet e Propozuara të Strukturave dhe/ose Parcelave
4.2	Hapësira e Zënë me Ndërtesa
4.3	Panja e Jashtme e Godinave / Trajtimi i Fasadave / Trajtimi i Mbulesave
4.4	Përcaktimin e Treguesve për Zhvillim për Secilën Parcelë
4.5	Rregullat e Zhvillimit
4.6	Vendqëndrimi për Automjetet
5.	Rregullat e Rrjeteve të Infrastrukturës
5.1	Pozicionimin e Shërbimeve dhe Rrjeteve Kryesore të Infrastrukturave
5.1.1.1	Rrjeti Rrugor
5.1.1.2	Rrjeti i Furnizimit me Energji elektrike
5.1.1.3	Impianti i Mbrojtjes Kundra Zjarrit
5.1.1.4	Impianti i Shkarkimit të Ujrave të Zeza
5.1.1.5	Impianti i Furnizimit me Ujë
5.1.1.6	Impianti i Shkarkimit të Ujrave të Shiut
5.2	Hapësirat e Lira dhe të Gjelbërta
6.	Fazat e Zhvillimit të Lejes së Ndërtimit
7.	Relacionin e Menaxhimit të Inerteve të dala si rezultat i punimeve që do të kryhen për realizimin e projektit.

8. Impaktet Kryesore në Mjedis

8.1 Impakt mbi Sipërfaqen e Tokës

8.2 Impakt mbi Ujërat Sipërfaqësore

8.3 Impakt mbi Ujërat Nëntokësore

8.4 Impakt mbi Biodiversitetin (Flora, Fauna, Habitatet, Pyjet etj)

8.5 Impakt mbi Menaxhimin e Tokës dhe Mbetjeve

8.6 Impakt mbi Peizazhin

8.7 Impakt mbi Zhurmat dhe Ajrin

8.8 Impakt mbi Trashëgiminë Kulturore dhe Arkeologjinë

9. Aneke (Hartat në A3)

1. Dispozita të Përgjithshme

1.1. Baza Ligjore

- Ligji Nr. 107/2014, datë 31.07.2014 për "Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit"

1.2 Përshkrim i zonës së studiuar

Zona në studim është pjesë e Zonës Kadastrale nr. 8320 me nr.Pasurie :1/568 Vol.21 Fq.172 Universiteti Bujqesor Tirane me adrese : Kodër Kamëz. Siperfaqja e Pasurise Truall është 23 462 m2 prej të ciles janë 2 395 m2 Ndërtesa ekzistuese. Ndërtesat ekzistuese dhe truall i lirë rrethojne objektin që do ndërtohet i cili ka një siperfaqe prej 453 m2 dhe me një kat.

Territori i i ketij objekti përbëhet pothuajse nga terren i sheshtë.



1.3. Përkufizimi i termave të përdorur

1. Në këtë rregullore, termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

"**Strukturë**" është çdo objekt i ndërtuar ose i instaluar në territor, që ka vendosje të palëvizshme ose të përkohshme dhe sipas rastit, përfshin tokën mbi dhe nën të cilën ndodhet struktura.


"**Zhvillimi**" Kryerja e çdo punimi mbi tokë, si dhe ndërtimet në të.

"**EN**" - Standarte Europiane të Materialeve dhe Kushteve të Projektimit (European Norms)

2. **Ekstrakte të Instrumentit të Përgjithshëm Vendor (nëse zona ku parashikohet zhvillimi ka një IPV të miratuar në KKT)**

2.1. Orientimet dhe Detyrimet që rrjedhin nga IPV

Bashkia Tiranë ka të miratuar Instrumentin e Përgjithshëm Vendor me Vendim nr. 1 datë 15.02.2013 të KKT-së. Referuar këtij vendimi, objekti që parashikohet të ndërtohet ndodhet në zonën me prioritet zhvillimi dhe nën njësinë strukturore 11/38. Sipas planit kjo njësi parashikon funksionin "Qendër Universitare, Rekreative, Terrene Sportive etj.



2.2. Rregullat, normat dhe standartet e zhvillimit

Objekti që do ndërtohet është brenda Pronës së UBT- së dhe normat e standartet e zhvillimit janë brenda çdo parashikimi të Rregullores së Instrumentit të Përgjithshëm Vendor. Referuar Rregullores së IPV-së të Bashkisë Tiranë, nën-njësia strukturore 11/38 parasikon rregullat e përdorimit si më poshtë:

1. Kategoritë e lejuara të përdorimit të tokës dhe strukturave në të:

Zonë me prioritet zhvillimi, e Përzier (Mikse) Shërbime Publike dhe Banim. Gjatë hartimit të PDV-ve duhet të ruhet raporti mes kategorive të përdorimit.

2. Llojet e lejuara të përdorimit dhe të zënies së territorit

Lejohen zhvillime brënda nënkategorive të lejuara të përdorimit të tokës dhe strukturave në të. Përdorimi dhe zënia e territorit lejohet për zhvillimin e banesave me aktivitete të kombinuara, në përputhje me rregullat e nën-njësi strukturore të banimit. Aktivitetet tregtare janë të lejuara në katet e para të objekteve.

3. Përdorimet e papërputhshme

Çdo lloj përdorimi i papërputhshëm me kategoritë e lejuara të përcaktuara në pikën 1 më sipër.

4. Tipologjitë e propozuara të strukturave

Zhvillime të strukturave të larta për përdorim banimi.

5. Llojet e ndërhyrjes në territor

Rindërtim ose Rizhvillim.

Kjo nën-njësi do të trajtohet me PDV si nën-njësi me prioritet zhvillimi me qëllim krijimin e një poli zhvillimi për qytetin me zhvillime të karakterit arsimor, argëtimi, rekreative, sportive si dhe hapësira publike të llojit natyror. Raporti mes dy kategorive të përdorimit duhet të mbetet i pandryshuar.

Aktualisht në nën-njësi për kategorinë Banim, mbizotërojnë struktura të uëlta të cilat do të nënshtrohen rizhvillimit sipas përcaktimeve të PDV-së.

Ndërhyrja në territor do të bëhet sipas propozimeve të PDV- së, të cilat duhet të mbajnë në konsideratë përmirësimin dhe shtimin e infrastrukturave publike për qytetin.

6. Zënia e territorit

Ksht për çdo strukturë do të përcaktohet me PDV, duke synuar Kusht më të lartë për strukturat bazë rrugëve kryesore të njësisë dhe me të ulët në brendësi, me qëllim shtimin e hapësirave të hapura për nën-njësinë.


7. Lartësia e propozuar e strukturave e shprehur në kate

Lartësia e propozuar në kate dhe lartësia në metra e strukturave do të përcaktohet në PDV, duke mbajtur parasysh lartësitë minimale të kateve (në metra) sipas llojit të përdorimit.

8. Vija e ndërtimit

Të respektohet vija e ndërtimit e krijuar. Në parcelat të cilat rihvillohen dhe nuk kanë vijë ndërtimi, të përcaktohet nga PDV madhësia në metra e tërheqjes nga trupi i rrugës së propozuar ose ekzistuese sipas rastit.

2.3. Seti i fragmenteve të hartave të IPV për zonën në zhvillim



Fragment nga Plani i përdorimit të propozuar të tokës së IPV Bashkia Tiranë

NËNKATEGORITË E PROPOZUARA PËR PËRDORIMIN E TOKËS DHE TË STRUKTURAVE NË ZONAT ME PRIORITET ZHVILLIMI			
1	11/34 : terrare për ofisime profesionale dhe shërbime tregëtare dhe tregëtare	4	11/32 : terrare për ofisime profesionale dhe shërbime tregëtare dhe tregëtare
2	11/35 : terrare për ofisime profesionale dhe shërbime tregëtare dhe tregëtare	5	11/33 : terrare për ofisime profesionale dhe shërbime tregëtare dhe tregëtare
3	11/36 : terrare për ofisime profesionale dhe shërbime tregëtare dhe tregëtare	6	11/34 : terrare për ofisime profesionale dhe shërbime tregëtare dhe tregëtare
		7	11/35 : terrare për ofisime profesionale dhe shërbime tregëtare dhe tregëtare
		8	11/36 : terrare për ofisime profesionale dhe shërbime tregëtare dhe tregëtare
		9	11/37 : terrare për ofisime profesionale dhe shërbime tregëtare dhe tregëtare
		10	11/38 : terrare për ofisime profesionale dhe shërbime tregëtare dhe tregëtare
		11	11/39 : terrare për ofisime profesionale dhe shërbime tregëtare dhe tregëtare
		12	11/40 : terrare për ofisime profesionale dhe shërbime tregëtare dhe tregëtare
		13	11/41 : terrare për ofisime profesionale dhe shërbime tregëtare dhe tregëtare

Nënkategoritë e propozuara për përdorimin e tokës dhe të strukturave në zonat me prioritet zhvillimi.

11	11/34 : terrare për ofisime profesionale dhe shërbime tregëtare dhe tregëtare, zyra, qendër biznesi dhe shërbime tregëtare profesionale dhe mbeshfetëse, terrare të pashitatura për aktivitete rekreative dhe sportive
12	11/41 : shërbime publike të lojës rekreative dhe shërbime infrastrukturore, stacioni multimodal i transportit publik
13	11/38 : qendër universitare, rekreative, terrare sportive, etj.

Zona me prioritet zhvillimi 13

3. Analiza e Gjëndjes Ekzistuese (elementët ekzistues të territorit)

3.1 Informacion për topografinë e zonës.

Sheshi i ndërtimit ndodhet në një zonë me një pjerrësi të lehtë, pothuajse të pa përfillshme, ne te gjitha drejtimet e horizontit, ku sipërfaqja e sheshit është pothuajse e rrafshët me ndërtime ekzistuese.

Parcela pothuajse e vendosur në një terren të rrafshët, është e formuar me ndërtime ekzistuese nga ana veriore jugore dhe ana lindore, të cilat do të funksionojnë së bashku me ato të propozuarat. Ndersa nga ana perëndimore është një rrugë në zhvillim.



3.2. Informacion për burimet natyrore dhe mjediset pyjore (nëse IPV ka parashikuar zona të tilla)

Për këtë zonë nuk janë parashikuar apo evindentuar zona si burime natyrore dhe mjedis pyjore. E gjithë zona është e formuar me godina me karakter social e shkollor. Parashikohet që në të ardhmen të kemi mbjellje pemësh dekorative.

3.3. Informacion mbi zonat e mbrojtura natyrore dhe ato të trashëgimisë kulturore edhe historike

Zona ku do të zhvillohet ndërtimi, është një zonë e formuar dhe në gjithë historikun e saj ka qenë një zonë truall në pronësi të UBT-së. Nuk kemi ndikime negative në aspektin e trashëgimisë kulturore e historike.

3.4. Informacion mbi infrastrukturën ekzistuese të zonës për zhvillim dhe zonave përreth saj

Infrastruktura rrugore është e formuar pjesërisht pasi në të ardhmen parashikohet ndërhyrje në përmirësimin e rruges "Taulantia". Parcela ndodhet lehtësisht e aksesueshme nga rruga nacionale. Objekti propozohet të zhvillohet në një parcelë në të cilën do të kemi përmirësim të infrastrukturës ekzistuese. Infrastruktura ekzistuese shtrihet deri në parcelën që do të zhvillohet, duke krijuar lehtësira në zhvillimin e godinave ekzistuese. Qarkullimi për në parcelë do të bëhet sipas pozicionit që diktojnë vetë godinat, duke ndjekur sistemin e brendshëm rrugor ku përveç infrastrukturës ekzistuese plotësohet dhe me rrugë të reja.

Përgjithësisht zona nuk ka mungesa të furnizimit me ujë. Furnizimi bëhet nga vetë Institucioni përfitues i projektit dmth nga UBT-ja.

Po kështu UBT-ja është e pajisur me rrjetin e ujrave të zeza.

Gjendja e furnizimit me energji elektrike nuk është problematike. Zona furnizohet nga rrjeti ekzistues

3.5. Përmbledhje dhe gjetjet kryesore të Analizës të Gjëndjes Ekzistues

Objekti ndërtohet në një zonë fushore rrethuar me ndërtime një e tre kat ekzistuese

Përdorimi aktual truall për ndërtese një kat me karakter social – shkollor.

Infrastruktura e zonës është funksionale, me sistem rrugor të aksesueshëm, rrjet kanalizimesh dhe rrjet furnizimi me energji elektrike ekzistues.

4 Rregullat e Zhvillimit të Territorit

4.1 Funksionet dhe aktivitetet e propozuara të strukturave dhe/ose parcelave

I gjithë zhvillimet në territor është në përputhje me kategoritë e lejuara të përdorimit të tokës.

Sipërfaqja totale e parcelës prej 23 462 m² është e përfshirë nën kategorinë e sipër përmendur. Përdorimi i strukturës së re është tërësisht me funksion si të mesimdhënies me sipërfaqe totale ndërtimi 453 m² me një kat dhe sipërfaqe gjurme 453 m².

4.2 Hapësira e zënë me ndërtesa

Sipërfaqe e zënë nga struktura të propozuara (gjurma): 453 m².

Sip. e përgjithshme e ndërtimit nga struktura ekzistuese: 2 395 m² + 453 m². = 2 848 m²

Koefiçenti i shfrytëzimit të truallit për ndërtim 12.1 %.

Intensiteti i ndërtimit: $i = 0.12$

Lartësia maksimale e strukturës nga niveli i kuotës së sistemimit: 5.2 m.

4.3 Pamja e Jashtme Godinave/Trajtimi i fasadave/Trajtimi i mbulesave



Zona që zhillohet është një zone sociale dhe strukturat që do të zhillohen në këtë zonë do të jenë me materiale të lehta, konstruksion miks (beton arme dhe metalik), me soleta monolite.

Ky objekt do të plotësojë peisazhin e zonës dhe përmireson imazhin në kuadër të zhvillimeve të reja që do të behen në të ardhmen.

Arkitektura është e thjeshtë dhe respekton linjat e pastra geometrike dhe kuadratike në strukturat e zhvilluara. Duke qenë një objekt social respektohen normat për sipërfaqet e hapura të xhamit, normat për hyrje-daljet dhe qarkullimin e studenteve, ngjyrat që duhet të përdoren, materialet që duhet te përdoren, lartësitë e ambjenteve etj. Materialet që do të përdoren për zhvillimin e godinës, do të jenë :

-Betone, b/arme, hekur, tulla, pllaka shtrese e veshje, suva plastike e ngjyrosur (ngjyrë pana dhe verdhe e hapur) etj

4.4 Normat e zhvillimit për secilën parcelë

Lartësia e katit

Lartësia e strukturës jepet në metra.

Lartësia e katit përdhe është maksimal 5.2 m.

Koeficienti i shfrytëzimit të tokës për hapësira publike (K_{shp}) është raporti i sipërfaqes së gjurmës së strukturave dhe territoreve të hapura për hapësira publike, si gjelbërim, territore sportive, sheshe lojërash etj., në parcelë me sipërfaqen bruto të parcelës.

Sipërfaqja e ndërtimit është 453 m^2 me k.sh.p. 12.1%.

4.5 Rregullat e zhvillimit

Zona e ndërtimit duhet:

- të lidhet me rrugët egzistuese në të dy drejtimet;
- të respektojë distancat nga qendrat e banuara në varësi të llojit të aktivitetit dhe treguesve mjedisorë, sipas përcaktimeve të legjislacionit të posaçëm në fuqi;
- të ketë një rrjet të infrastrukturave të pavarur nga ai i qendrës dhe i zonës së banuar;
- të përmbajë edhe zonat dhe zgjidhjet e brendshme për trajtimin e mbetjeve të të gjitha llojeve

Tipologjitë e propozuara të strukturave

Tipologjia e strukturës në projekt është strukturë me lartësi një kat. 5.2 m

Koeficienti i shfrytëzimit të tokës

Koeficienti i shfrytëzimit të tokës është 12.1% e parcelës.

Intensiteti i ndërtimit

Intensiteti i ndërtimit është $i = 0.12$.

Trajtimi i sipërfaqeve të gjelbra

Sipërfaqet janë trajtuar me gjelbërim të ulët të tipit bar dhe bime dekorative.

Vija e ndërtimit

Objektet e propozuara duhe të respektojnë vijën e ndërtimit të krijuar.

4.6 Vendqëndrimi për Automjetet / Parkimet

Parkimet janë vendosur në hapësirën e sheshit të krijuar në brendësi të parcelës së përgjithshme, duke shfrytëzuar hapësirat ekzistuese.

5. Rregullat e rrjeteve të infrastrukturës

5.1 Pozicionimet e shërbimeve dhe rrjeteve kryesore të infrastrukturës

Të gjitha sistemet e infrastrukturës (ujë, energji elektrike, kanalizime dhe telekomunikacioni), janë të vendosen në sipërfaqen e tokës dhe do të jenë të sistemuara në një korridor qendror infrastrukture brenda rrjetit ekzistues të UBT -së.

Për sa i përket rrjetit inxhinierik, ku përfshihen:

- sistemimi i ujrave të zeza;

- rrjeti elektrik dhe ai i ndriçimit të rrugës;
- rrjeti i furnizimit me ujë, etj

duhet të parashikohen të ndërtohen nën zonën e trotuareve.

5.1.1 Rrjeti rrugor

Rrjeti rrugor është përgjatë ndërtesave ekzistuese një e tre katëshe.

5.1.2 Rrjeti i furnizimit me energji elektrike

Objekti furnizohet nga rrjeti ekzistues në pikën e lidhjes më të afërt brenda institucionit. Në ambientin e godinës do të bëhet vendosja e paneleve të tensionit të ulët për hyrje-dalje të linjës dhe paneli i matjes së energjisë elektrike në tensionin e ulët.

5.1.3 Impianti i Mbrojtjes Kundra Zjarrit

Sistemi i mbrojtjes kundër zjarrit është realizuar në bazë të:

Normave, rregulloreve dhe kriterëve projektuese të vendeve të Komunitetit Europian si dhe në përputhje me rregulloret MKZSH në Shqipëri.

Për të përdorur agjentë shuarës të përshtatshëm gjatë procesit të mbrojtjes nga zjarri, në funksion të materialeve që mund të marrin flakë, janë marrë në konsideratë klasat e zjarrit. Në projekt janë përcaktuar me saktësi zonat sipas klasit të zjarrit dhe në përputhje me to janë zgjedhur lloji i fikseve portative (bombolave) si dhe hidratet e zjarrit.

Impiantet e palëvizëshme të shuarjes së zjarrit:

Hidrante në brendësi të godinës

Lidhjet me autopompën (aplikohen në pozicionet më përshtatshme për lidhjen e automjeteve të zjarfikëseve)

5.1.4 Rrjeti i shkarkimit të ujravë të zeza

Ky sistem vetëkuptohet shërben për shkarkimin e ujrave të zeza nga ambientet hidrosanitare të godinave. Ai është i përbërë nga rrjeti i brendshëm i ambienteve sanitare, nga kalimet horizontale të tyre në tokë, deri në pusetat primare ose pusetat mbledhëse të kolonave dhe lidhja e tyre me rrjetin të jashtëm në aksin e rrugës dhe shkarkimi i tyre në rrjetin ekzistues të zonës.

Për shkarkimet e ujrave do të përdoren tuba plastike PP (polipropilen i termostabilizuar në temperatura të larta) që plotësojnë të gjitha kërkesat e cilësisë sipas standartit EN 1451 (Kërkesa për testimin dhe kualitetin tubove). Ata janë dizenuar në përputhje me standartin EN 12056.

Lidhja e tubave të dërgimit duhet të bëhet me tridegëshe të pjerrëta nën një kënd 45 ose 60 gradë. Tubat e dërgimit mund të shtrohen anës mureve, mbi ose nën soletë duke mbajtur parasysh kushtet e caktuara për montimin e rrjetit të brendshëm të kanalizimeve. Gjatësia e këtyre tubave nuk duhet të jetë më tepër se 10 m. Diametri i tyre do të jetë në funksion të daljeve të pajisjeve sanitare që janë vendosur.

5.1.5 Rrjeti i Furnizimit me Ujë

Furnizimi i ujit të ftohtë sanitar bëhet nëpërmjet rrjetit të jashtëm nga puseta e kontrollit brenda rrjetit ekzistues të UBT- sc. Nëpërmjet prurjes dhe presionit që ka rrjeti i jashtëm bëhet furnizimi i rezervave të përgjithëshme të ujit të vendosura në ambientet teknike.

Dimensionimi dhe projektimi i të gjithë komponenteve dhe aksesorëve të sistemit të furnizimit dhe të shpërndarjes të ujit të ftohtë dhe të ngrohtë sanitar është realizuar duke marrë në konsideratë të gjithë elementet e duhur teknike:

5.1.6 Sistemimi i Ujrave të Shiut

Ky sistem shërben për shkarkimin e ujrave të shiut dhe përbëhet nga sistemi i piletave dhe kolonave të mbledhjes së ujrave të tarracave. Ujrat e tarracës nëpërmjet piletave dhe kolonave kalon në pjesët horizontale të tyre, në pusetat mbledhëse për të shkarkuar në rrjetin ekzistues të zonës.

5.2 Hapësirat e Lira dhe të Gjellërta

Hapësirat e lira synojnë më tepër drejt hapësirave rekreative të pajisura edhe me elementë të mobilitetit urban. Sipërfaqja e gjelbërt është e tipit bar, shkurre dekorative si dhe disa pemë me lartësi deri 4 m, përreth bordurave, lule dekorative dhe aromatike në brendësi të sipërfaqes.

6. Fazat e Zhvillimit të Lejes së Ndërtimit

Ndërtimi i godines nje kateshe me siperfaqe 453 m² do të ndjekë fazën e zhvillimit sipas grafikut të punimeve. Periudha kohore e parashikuar për fillimin dhe përfundimin e punimeve sipas grafikut të punimeve parashikohet rreth 7 muaj.

7. Relacioni i Menaxhimit të Inerteve të dalë si rezultat i punimeve që do të kryhen për realizimin e projektit.

Për ndërtimin e strukturës së objekteve që propozohen nevojitet kryerja e punimeve të gërmimit, ku materiali i gërmuar do të përdoret për nivelimin e sheshit pas përfundimit të punimeve i cili do të nivelohet e më pas gjelberohet me barë, shkurre etj.

Volumi i materialeve të tjera të parashikuar që do të dalë nga punimet e betonit, tullës, suvasë etj. dhe nga kryerja e punimeve do të përdoren për mbushjen e shtresës në kuotën +/- 0.00

8 Impaktet Kryesore në Mjedis

8.1 Impakt mbi sipërfaqen e tokës

Sipërfaqja e truallit të zënë me këto ndërtimte ri është në masën prej 12.1 %. Pra kemi shumë sipërfaqe të lirë e cila mund të zhvillohet në të ardhmen.

8.2 Impakt mbi Ujërat Sipërfaqësore

Ujrat sipërfaqësore sistemohen lehtë për faktin që objekti është në fund të zonës ku zhvillohet e mund të largohen në drejtim të kolektoreve të zonës

8.3 Impakt mbi Ujërat Nëntokësore

Sipas studimit gjeologjik – inxhinierik ujrat nëntokësore nuk përbejnë shqetësim për objektin që po zhvillohet

8.4 Impakt mbi Biodiversitetin (Flora, Fauna, Habitatet, Pyjet etj)

Ndërtimi i objektit me një lartësi maksimale 5.2 m e një sipërfaqe 453 m² në një zonë lehtësisht të menaxhuar nuk mund të ketë probleme në florë, faunë etj për më tepër që do kemi sistemim të mirë të sipërfaqes së gjelbert

8.5 Impakt mbi Menaxhimin e Tokës dhe Mbetjeve

Duke ditur që koeficienti i shfrytëzimit të tokës është vetëm 12.1 % të sipërfaqes garantohej me se mirë si menaxhimi i tokës ashtu edhe i mbetjeve

8.6 Impakt mbi Peizazhin

Në një zonë të hapur siç është vendosur objekti një kat peizazhi vetëm se është me i kënaqshëm e me relaksues pasi fasada është rregulluese e peizazhit

8.7 Impakt mbi Zhurmat dhe Ajrin

Zona ku zhvillohet objekti, sipërfaqja që zë, lartësia mbi tokë dhe destinacioni për mesimdhënie i japin një ndjesi të mirë gjithësecilit si një ambient i këndshëm

8.8 Impakt mbi Trashëgiminë Kulturore dhe Arkeologjinë

Zona ku zhvillohet objekti i përket një vendi në të cilin nuk kemi impakt negativ për trashëgiminë kulturore e aq më tepër asaj arkeologjike për të cilën kemi marrë konfirmim nga institucioni përkatës

9. Aneks (Hartat në format A3)

1. Harta e planvendosjes së strukturës së godinës “Qendra e Trajnimit për Arsimin Profesional”, Kamëz, Tiranë
2. Plani i Sistemit
3. Pamje 3 Dimensionale të Objektit



"SPEED" SH.P.K.



EMERTIMI I FLETES	PLANVENDOSJA E OBJEKTIT	FLETA NR.	A.01
SHKALLA	DATA	09.2014	
1:500			

INVESTITOR	Slovenia's Development Cooperation & USAID
IMPLEMENTUES	Qendra ballkanike per bashkepunim dhe zhvillim
EMRI PROJEKTT	OBJEKT 1 KAT
QENDRA E TRAJNIMIT	QENDRA E TRAJNIMIT PROFESIONAL,

OBJEKT 1 KAT
 QENDRA E TRAJNIMIT PROFESIONAL
 FAKULTETI I MJEKESISE VETERINARE , UBT.

PROJEKTI ARKITEKTONIK



INVESTITOR Slovenia's Development Cooperation & USAID

IMPLEMENTUES Qendra ballkanike per bashkepunim dhe zhvillim

GRUPI I PROJEKTIMIT

Punoi Ing.Blerina Hoxha
 Punoi Ing.Petraç Koka Liç.
 Kontrollori ark.urb. Entela Kojë (Spektror)



Colly Kojë